

Le ta ndihmojmë vetveten duke ndihmuar Universitetin e Prishtinës

Uk Lushi dhe Qëndrim R. Gashi*

Nuk është e rastësishme që diskutimet dhe vendimet rreth Universitetit të Prishtinës zënë shpesh vend të rëndësishëm në diskursin tonë publik. UP-ja, si universiteti më i madh dhe më i vjetër në vend, vazhdon të jetë institucioni qendror i arsimit të lartë dhe i shkencës në Kosovë që ka vlerë historike për popullin tonë dhe ndez emocione për shumë bashkëqytetarë, të cilëve për një kohë të gjatë iu mohuan të drejta themelore, përfshirë të drejtën e shkollimit në gjuhën shqipe.

UP-ja u themelua falë angazhimit dhe betejave të vështira të gjeneratave të tëra të popullit tonë nën pushtim. Duke mbrytur breza të shumtë me dije dhe ideale të lirisë, në fakt, kjo çerdhe e edukimit, shkencës dhe artit, është njëri nga prindërit e lindjes së UÇK-së. Ndërsa flasim për ish-ushtarët dhe familjarët e tyre—pjesën më fisnike të popullit dhe së cilës i detyrohemi jashtëzakonisht shumë për lirinë që e gëzojmë—duam të bëjmë të qartë si kristali mirënjohjen tonë më të thellë për kontributin e tyre gjigant.

Mirëpo askush nuk ka të drejtë të përdorë ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare apo familjarët e tyre për të shkelur idealin dhe amanetin e UÇK-së për drejtësi dhe paanësi. Universitetet nuk janë fabrika të prodhimit serik të diplomave që nuk konfirmohen nga nxënia e diturisë siç nuk janë as ndërmarrje bamirësie apo filantropike.

Ne jemi të merakosur me trysnitë dhe ndërhyrjet flagrante të politikës dhe grupeve të caktuara të interesit në punën dhe procedurat autonome të UP-së. Shqetësimi ynë është shtuar veçanërisht ditëve të fundit ndërkaj vijon furtuna në gotë e regjistrimit dhe pranimit pa kaluar nëpër sitën e selektimit të mbi 1000 kandidatëve për studentë që rrjedhin nga familjet e ish-veteranëve të UÇK-së. (UP-ja tanimë e ka adresuar çështjen e fëmijëve të dëshmorëve duke u dhënë atyre pesë pikë bonus në start). Universiteti i Prishtinës si çdo institucion serioz i arsimit të lartë, si kritere vlerësuese primare duhet t'i ketë aftësitë studiuuese dhe rezultatet.

Afirmimi dhe diskriminimi janë dy koncepte të ndryshme dhe ky i dyti më së pakut duhet të nxitet dhe përkrahet nga Shoqatat e ish-ushtarëve të UÇK-së. Familjarët e luftëtarëve të lirisë duhet të gëzojnë të gjithë përkrahjen, privilegjet dhe të drejtat speciale që i

meritojnë, veçse nuk duhet që nën pretekstin e gjoja ndihmës së tyre të bëhen kompromise me diturinë sepse kështu dëmtohen si përfituesit ashtu edhe shoqëria.

Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së kanë bërë shumë për anëtarësinë dhe familjarët e heronjve të luftës, porse, nëse duan që të ndihmojnë konkretisht dhe si duhet kolegët dhe familjet sakrifikuese të UÇK-së, ato duhet të përqendrohen dhe kërkojnë përmbushje të obligimeve nga institucionet shtetërore, që janë përgjegjëse direkte për gjendjen jo të mirë të shumë familjeve të dëshmorëve, të invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së edhe pesëmbëdhjetë vite pas çlirimit. Memorandumet si zgjidhje të përkohshme dhe të paplota duhet të zëvendësohen me ligje adekuate për status, të drejta dhe benefite si zgjidhje e përhershme dhe precize siç është rasti i ushtarëve pjesëmarrës në luftëra në çdo shtet të botës.

Nga disa është keqpërdorur argumenti i gabuar krahasues mes kandidatëve të lidhur me UÇK-në dhe minoriteteve duke u shtruar pyetja se pse duhet të pranohen me njërin sy mbyllur shtetasit nga pakicat kombëtare dhe jo njerëzit e UÇK-së? Është një lajthitje naive të vihen paralele midis shumicës absolute dhe pakicës që nuk e ka fuqinë të ndikojë në mbingarkesë të një institucioni si UP-ja. Pyetja e duhur do të ishte: pse kanë sukses shumica e studentëve dhe akademikëve shqiptarë kur pranohen dhe studiojnë nëpër universitetet më të forta botërore? Dhe përgjigjja është: sepse institucionet arsimore-akademike të mirëfillta përdorin kritere të ashpra dhe studiuesit punojnë shumë të fitojnë kualifikimin dhe suksesin. Ndërsa institucionet e arsimit dhe shkencës në Kosovë, pothuajse si rregull, nuk i kanë standardet mjaftueshëm të larta dhe lejojnë të prodhojnë kuadër jo të mirëkualifikuara si me shumicën shqiptare si me pakicat.

Regjistrimi dhe pranimi i kandidatëve me automatizëm në institucione të arsimit, artit dhe hulumtimit shkencor i ngarkon ato me mbikapacitete që nevojisin rritje të hapësirës dhe kuadrit mësimdhënës dhe administrativ dhe tautologjikisht si rrjedhojë ndodh ulja e cilësisë dhe potencialisht dështimi i misionit arsimor dhe akademik. Gjendja në UP është e rëndë që shumë kohë dhe fajtorë për të jemi të gjithë nga pak. Që të shpëtojmë dhe përmirësojmë universitetin publik më të njohur të shtetit të Kosovës duhet të kontribuojmë dhe veprojmë së bashku dhe pa hezitar derisa të ndalet degradimi.

Shoqëria jonë nuk duhet të rrijë pasive. Ne i ftojmë studentët, profesorët, përfaqësuesit e popullit, intelektualët, punëtorët dhe çdo qytetar të ngrehin zërin dhe bëjnë çdo gjë që UP-ja të bëhet vatër e zjarrit dhe ndriçimit të diturisë. Ne jemi të bindur që shumica absolute e ish-pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjarëve të tyre do të jenë në ballë të këtij aktiviteti dhe kontributi.

Vlerat e luftës për liri dhe të UÇK-së mbrohen më së miri nëse nderohen dhe zbatohen principet e meritokracisë, kreativitetit dhe arritjes. Veteranët e UÇK-së dhe familjarët e tyre ndihmohen më së shumti duke mos lejuar persona të caktuar që për agjenda personale dhe grupe të manipulojnë listat e fëmijëve të ish-ushtarëve të UÇK-së, duke futur në to p.sh. të afërm të tyre ose kandidatë që paguajnë. Një njeriu të mirë dhe i cili do të jetë i dobishëm për shoqërinë dhe kombin nuk i nevojitet diploma pa njohuri dhe meritë sepse kjo është sikur njeriut t'i dhurohet trupi pa tru dhe vullnet të lirë. UP-ja duhet

të rikthehet në universitet ku përgatitja, dedikimi dhe puna e palodhur prodhojnë inovacion dhe krijimtari.

Nëse nuk i bëjmë universitetet tona si duhet dhe nëse nuk e bëjmë sektorin e arsimit prioritet numër një, nuk do të kemi as shtet dhe as jetesë si duhet. Le t'i ndihmojmë si UP-në ashtu edhe heronjtë e UÇK-së duke e bërë Universitetin e Prishtinës më cilësor dhe më konkurrues dhe duke e trasuar përgjegjësinë dhe meritokracinë individuale sepse kështu i ndihmojmë vetvetes.

**Uk Lushi dhe Qëndrim R. Gashi janë ish-studentë të UP-së. Lushi është i diplomuar për matematikë dhe ekonomi në Columbia University të Nju Jorkut dhe ka qenë ushtar i UÇK-së, ndërkaq Gashi është i doktoruar për matematikë në University of Chicago dhe tash punon si profesor në UP.*